
 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-698/022	Data: Datum: 20.09.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe nenit 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 12Nr.76/2022 të datës 13.09.2022 të parashtruar nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për vlerësimin e projekteve të OJQ-vë dhe individëve në fushën e Kulturës, Rinisë për anulimin e thirrjes publike të datës 30.05.2022 dhe nxjerr:

V E N D I M

1.SHFUQIZOHET: Vendimi 01Nr.350/2022 i datës 25.05.2022 për shpalljen e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve.

2. Anullohet thirrja publike e datë 30.05.22 për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve. Komisioni ka shqyrtuar të gjitha projektet e OJQ-ve të cilat kanë aplikuar në këtë thirrje publike dhe ka konstatuar se janë aktivitete të parapara të mbahen para thirrjes publike për mbështetje financiare dhe i ka rekomanduar Kryetarit për anulim.

3. Vendimi 01Nr.350/2022 i datës 25.05.2022, nuk është në fuqi nga data 20.09.2022.

4. Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që të rishpallë thirrjen publike pas tri ditëve.

5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

6. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Komisioni,
- Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije ŠUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI

